

MBI TIPOLOGJINË E RAPORTEVE LETËRSI-SHOQËRI: RASTI SHQIPTAR

Hamit XHAFERI

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Universiteti UEJL, Tetovë,

MAQEDONI

E-mail: h.xhaferi@seeu.edu.mk

PËRMBLEDHJE

Ecuria krijuese e veprimtarisë së shkrimtarit shqiptar ka qenë bukur shumë e ndërthurur me kontekstin historiko-social. Rrethanat historiko-sociale ndikuan ndjeshëm në hartimin e veprave letrare shqipe, por edhe letërsia ndikoi në një mënyrë ose në tjetrën mbi shoqërinë tonë. Ky raport i dykahshëm ka pasur peshën e vet në krijimin e gjinive, llojeve, në veçantitë e poetikave individuale, në shfaqjen, konsolidimin e dezintegrimit dhe shkallëshkallshëm të lëvizjeve e formacioneve letrare, në pasurimin e transformimit të gjuhës poetike dhe të ligjërimit letrar në përgjithësi. Kumtesa synon të ndriçojë në rastin shqiptar tipologjinë e raporteve letërsi-shoqëri, raporte këto më se thelbësore në procesin e evolucionit historik të një letërsie kombëtare.

Fjalët kyçe: *Letërsia shqipe, evolucioni historik, raportet e letërsisë me kontekstin historiko-shoqëror, tipologjia e raporteve, ndikimet e ndërsjella.*

Key-words: *Albanian literature, historical evolution, literature relationship with socio-historical context, the typology of relations, the respective influences.*

HYRJE

Letërsia shqipe dhe artet e tjera janë pjesë e pasqyrës së zhvillimit të shoqërisë shqiptare.

Vjershëtoria apo letrari shqiptar nuk është një botë e pazakontë, me zotësi e prirje të brendshme a të jashtëzakonshme. Ai jetoj dhe gjelloi në ambientin e shoqërisë në kohëra dhe rrethana të caktuara dhe detyrimisht në krijimtarinë e tij letrare i pasqyroj synimet, pikëpamjet, vetëdijet dhe pikësnyimet e shoqërisë në të cilën jetonte.

Koha dhe rrethanat historiko-shoqërore kanë ndikuar në krijimin e gjinive dhe të llojeve letrare, në paraqitjen e lëvizjeve e të kaheve letrare, në pasqyrimin e gjuhës dhe ligjërimeve të shumënduarshme letrare. Në këto rrethana të caktuara, në shek. XIX dhe vijimin e atij XX, u krijua letërsia jonë e Rilindjes. Kjo rrjedhë zhvillimi i dha shtysë e nxitje krijimit dhe shtjellimit të letërsisë së re, të njohur me emrin Rilindja kombëtare. Si art letrar në këtë periudhë mori hov në përgjithësi poezia, sidomos ajo lirike. Letërsia e Rilindjes, duke qenë nën ndikimin e këtyre rrethanave, ishte përgjithësisht romantike. Ajo i takon romantizmit përparimtar shqiptar. Në këso kushtesh të caktuara dolën në dritë krijimet letrare të shkrimtarëve tanë, si të: Jeronim de Radës, Gavril Darës të Riut, Naim Frashërit, Çajupit, Asdrenit, Mjedës, Nolit, Migjenit e të tjerëve. Duhet thënë se kjo letërsi e Rilindjes u krijua me zell, vëmendje e pasion, pasi këto ishin temat me vlera madhore të shkrimtarëve të Rilindjes që ishin aktuale për

atë kohë. Në këtë mënyrë kushtet historiko-shoqërore ndikuan në përpilimin dhe aktualizimin e këtyre temave. Së këtëjmi vërehet qartë vlera e rëndësishme dhe dobiprurëse e letërsisë dhe artit. Letrari Milto Sotir Gurra, me kolegët e mendimit dhe pikëpamjeve shembëllyese të penës Nolin dhe Gramenon, patën një rol të rëndësishëm në historinë e letërsisë shqiptare gjatë viteve të fundit të Rilindjes dha pas saj.

Për të ndjerë dhe njohur pamjen letrare të kohës sonë si dhe atë çka ndodhi me letërsinë shqipe gjatë pjesës së parë të këtij shekulli na duket e domosdoshme të pikëzohet shtjellimi dhe tiparet e ngjarjeve artistike në lakun kohor të viteve '39-'44, e cila saktësohet qartë me fillimin dhe përfundimin e Luftës së përbotshme. Pa mëdyshje që rrjedhat e ngjarjeve politike joshën letrarët e shkathtë, duke aktivizuar kështu përfshirjen e një morie krijuesish. Këtu hetojmë se si krijuesit letrarë kanë paraqitur me kolorite jetëdhënëse e mallëngjyese panoramën e realitetit të asaj kohe. Megjithatë ka gjëlluar një jetë zhvillimore zakonisht letrare në të cilën atë botë morën pjesë pena letrare më të shquara, e një pjesë e tyre me vlera të gjithmbarshme. Lufta e përbotshme dhe pushtimi fashist kushtëzuan dhe saktësuan veçoritë e rrjedhave zhvillimore të mbarështimit dituror letrar të asaj kohe. Duke anashkaluar njëanshmërisht parashikimet për fashizmin dhe politikën e tij në Shqipëri e ndër shqiptarë, nuk kundërshtojnë dot që gjendja politike përçoi atë kulturoren duke e vënë këtë të dytën në rolin e së parës. Edhe pse thënë ndryshe fashizmi u orvat ta bëjë për vete gjëllimin kulturor dhe letrar. Çensura pengon, ndërpret dhe shuan gazetatat dhe revistat që dilnin përpara prillit '39 duke filluar me *Gazeta e Korçës* deri tek *Përpjekja Shqiptare*, shpronësohen dhe asgjësohen shumë vëllime e tekste letrare të bibliotekës "Lady Carvanon". Sekuestrohen dhe mënjanohen nga libraritë tekstat në frengjisht dhe në tërësi të gjithë librat jo në italisht. Ndërkohë nis publikimi dhe predikimi mashtrues i gazetave të ndryshme të politizuara si *Liktori* në Korçë ose *Balli i Rinisë* e publikime të ndryshme mbi jetën e Duçes. Publikoheshin dhe mbështeteshin tekste me veçori politike madje brenda në Shqipëri nisnin të publikohen tekste të ndryshme në italisht.

Thesojmë këtu dënimin dhe persekutimin e krijuesve dhe publicistëve si Petraq Pepo, Dhimitër Falo, Zhan Gorguzi etj. Thënë me fjalë të tjera, jeta kulturore, krahasuar me periudhën e sundimit të Zogut është tjetërsoj, sadoqë gjatë periudhës së komunizmit është anatemuar çdo gjë në këtë kohë padrejtësisht.

Krijuesit letrarë me veprat e tyre kanë aftësinë të përcaktojnë traditën letrare, "letërsinë kombëtare", "vlerë në vetvetë", rrethana të caktuara historike (Plasari A., 1996:13). Mbase përmes ringjalljes fillestare të krijimeve individuale shihet vetëm perspektiva e së nesërme? Me gjasë dhe përfundimi brenda kuadrin të kohës bashkë me korpusin e jetës shpirtërore të saj? Kushti dhe çështja vendimtare do të afrohet kur do të futemi thellë në hullinë e çelur. Ngjashmëri e mundshme midis ndikimit të rrethanave historiko-shoqërore në letërsinë shqipe gjatë shek. XIX-XX dhe asaj të mirëfilltë, interpretohet si një konotacion sociokulturor i ndryshueshëm dhe pothuajse nuk ekziston vijë ndarëse e njëmendtë. Ashtu siç mbeten problemet dhe idetë, yllësia dhe plejada e përkohësisë së përfaqësuesve të letërsisë, gjegjësisht poezisë, i ngërthejnë të tëra veçoritë dhe tiparet e ndjeshmërisë, vrazhdësisë, sidomos të çuditshmërisë dhe qartësisë. Me të drejtë shtrohet pyetja se brenda një kohe të krijimtarisë letrare në prozë, kujt i hyjnë në përdorim apo i ndihmojnë tematikat lirike romantike? Mjeshtëria poetike gati sa nuk ia ka zënë gllënjë mjellmës së bukur të kohës së vërtetë, që mund të duket e arritshme dhe asfare. Përballë dënimin të vrazhdë të llupës së diktaturës komuniste si ta kumtojnë shfaqjesimin apo mbrojtjen e vet autori dhe vepra e tij?

Kjo kohë prej katër dekadash, sidoqoftë nuk mundi ta shlyente këtë krijimtari letrare prej memorjes, por ama i solli pasoja të rënda mendimit të fjalës së lirë letrare. Planifikimi dhe parashikimi, në një mënyrë do të plotësojnë dhe ripërtërijnë çfarëdo kujtese riprodhuese. Gjendja dhe rrethanat e mjedisit në këtë fushë të veprimtarisë haptazi do të barazohen me botën ngazëllimtare, pothuajse të zbrazët e të zhvlerësuar. Përveç kësaj, sidomos në dy dekadat e fundit të para Luftës së Dytë Botërore, pa ndonjë shtrëngesë apo censurë vërehen ca liri shprehjesh letrare, veçanërisht po-

etike. Në rrethana të pashmangshme si poezia ashtu dhe proza do ta përballojnë atë që patëm pohuar, si gjendje dhe rrethanë vështirësuese që e rëndonte edhe më tepër gjendjen e vërtetë të letërsisë. Mbase kjo veprimtari aso kohe për krijuesit tanë që dëshirë dhe kënaqësi vetjake e vetme, apo fshehtësia e mbrame në rrethanat perënduese të kohërave, veçanërisht të çështjeve që kanë të bëjnë me poezinë dhe prozën. Shoqëria shqiptare, i këndonte këngët poetike me nota të muzikës së lehtë që kishin fituar namin dhe ishin përhapur gjithandej. Krijuesve të rinj ia tërhiqte vëmendjen sidomos arti i lartë ezoterik poetik. Një gjë e tillë këtyre penave u dukej sikur shëmbëllenin, bluanin, thërrmonin, zbrërthenin dhe shpjegonin në hollësi kohërat e shkuara të këtij avangardizmi poetik. Por akoma në këtë kohë njeriu fitonte përvojë nga marritë, ndërsa krijuesit letrarë nga zhdërvjelltësia dhe zgjuarsia e poezisë dhe prozës, fitonin forcën, guximin dhe besimin. Mirëpo njëmendësia e tmerrshme e kohës shumë shpejt dhe në mënyrë të vrullshme do ta shterr çfarëdo domethënie për shaka të hollë e dashamirëse. Mbuaroja e pozisë dhe prozës goditet pa mëshirë që duket shumë rezistente. Kjo ndodh, pikërisht ashtu si në prag të grafullimit shkatërrues të cunamit në bllokun e lindjes.

Por artet poetike censurose, nuk e ndëruan tërësisht natyrën e vërtetë magjike shqiptare, edhe pse u lëkundën. Si të tilla do të mbeten mbresa momentale që rrinë pezull. Këtu e kami fjalën tek qarqet që u shquhen me zhvillimin e zgjimit dhe mbarështrimit të vlerave artistike pothuajse muzeale. Me mbretërinë e mirëfilltë letrare shqiptare mbizotëron një regjim dhe rregull plotësisht i kundërt i lojës. Me të drejtë e pyesim veten tonë, çfarë roli dhe kuptimi ka sot letërsia, krijimtaria letrare në të, sidomos poezia, proza kur dihet se janë trashëguar nga bota e brendshme melankolike, nga mjekimi dhe kurimi i ndërgjegjes së njerëz moderne – brenda përcaktimit të ashtuquajtur realizëm socialist në Shqipëri dhe brenda ndjekjes së çdo fjale të lirë të krijimtarisë letrare ndër shqiptarët e ish Jugosllavisë. E mos të flasim për postmodernen, marramendëse, të arsyeshme por praktikisht të mjegulluar në rastin shqiptar?

Ndër krijuesit letrar shqiptar, matanë dhe këtej

kufirit shqiptaro-shqiptar shtrohej me të drejtë dhe pyetja tjetër: a thua poezia e shpreh edhe më pas lojën e moçme të gjithanshme, po atë lojë, që e shpërbëjnë dhe e vrasin regjimet antipopullore të kohës gjer në motivimin më të lartë tronditës? Ndonëse hëpërhë kjo kumbon apo ushton në trajtë apo formë sado sarkastike. Disa nga krijuesit tanë do të konsiderohen në higgjësend, perspektiva e së nesërme për ta të bëhet dhe shndërrohet më vonë në çdo gjë? Një gjë e tillë për një kohë nuk do të ndodh as këtupari, as tejmatanë, sepse humbet shëmbëlltyra si faqe vetjake, pasi bridhet me maska. Por krijuesit disidentë kryekëput do të gjykojnë se kjo lojë e ka kohën e skadimit dhe se është në tranzicion, mbase, në mes të udhës së Gomarit të Babatasit? Edhe pse filloi, në drejtim të botës me çehre dhe pamje njeriu, asnjëherë nuk ia doli në zgrip? Në mostjetër poezia, nën rrethanat e përkryera të ndërgjegjes heton dhe shqyrton përmbajtjen, domethënien a të qenurit, ka arsye të ligjshme të kuptojë – a përnjëmend gjëllojmë në kohë të vështira provash dhe lojërash? Mbase kjo duket si në katakomb, pa rrugëzgjdhje? Duke e kuptuar poetikisht, këtë rrugë njerëzore, këtë kohë të ndërsyer e cila kundërshton pa masë, dhe në fund detyrohet ta gëlltis përkufizimin e vet të vërtetë. Kësisoj edhe dialektika ekstreme e kohës s’i ka lënë anësh mjediset tona letrare.

Aspak s’do kishte arsye dramën ta glorifikojmë pasi çdo gjë duket këtejpari, gjer tek fryrja shumë-dramatike. Tek e mbrëmja, gjithashtu më vonë ndërmarrjet e vërteta fatlume, njësitë e shpikura të kohës së komunizmit për pastrimin e mendjes, në trajta të përgjithshme se kurorëzojnë dot organizimin njerëzor të kohës? Prapa maskës së prapësirës më të thellë ndoshta dhe më të papërfillshme, bota djallëzore në kuptim të menjëhershëm vepron në të gjitha kahet. Paralizimi dhe rrethimi i sotëm i historisë, shqetësimet e mesnatës përkundrejt vezullimit mesditor të rrugëtimit karakteristik individual, të përparimit në liri, kthehen në të vërteta. Kuvendimi i njëllajtë jopaqësor me vetveten, në mos detyrimi i prerë – kuptohet si pohim i më të vrullshmit për të përmirësuar kulturën e bashkëbisedimit. Aso kohe luftërat fetare godasin dhe kafshojnë mumien e vdekur të ndërgjegjes së lirë të krijuesit individual. Mjeshtëria e përgjithshme

e rregullimit të kodifikimit poetologjik, shprehja dhe përkufizimi i nivelit të riprodhuar me nxitimin e shumfishtë, në kuptimin shpërthyes bëhet dituri hulumtuese, adhurim qenësor i kohës. Mbase, fronësimi i përparimit – pikësynimi përfundimtar mbetet autori –vepra - receptuesi individual ose kolektiv? (Shema I., 1995) Në të vërtetë, paraqitje e forcës, egërsi dhe mizori e padëgjuar e antipoezisë zëmadohe dhe me famë qe vetëm prerje perspektivash e jo cak. Hiçgjësendi i mundshëm frikësues, matanë mbarësisë me të shëmtuarën ishte mohim veprash dhe autorësh. Errësira e apokalipsës së veshjes në hekur s'e merr vesh dot bisedën e njeriut. Në sistemin emancipues të arsyes, që përfundon në tërbim dhe lajthitje, kjo letërsi e kupton ankthën e vet. Evolucionin historik i letërsisë në shoqërinë shqiptare gjatë kohës së realizmit socialist zhvillohet mu si djalli i pamposhtur, po qe se merret urdhëri i paarsyeshëm, i njohur si taktikë e arsyeshme e mangësisë së plotë, shkon prapa botës së vet, e shkrumbosur gjer në pluhurin jashtëtokësor... Kurse renditja e ngjarjeve gjatë kësaj periudhe lidhet me kahjen e dëshmimeve të shtruuara, qysh kah fundi i qindvjeçarit, duke shfaqur ndërgegjen – me kthjelltësinë e ndikimeve të tërthorta nga letërsia frënge, italiane dhe gjermane. Ndonëse letërsia shqipe në relacion me disa letërsi ballkanike dhe evropiane ndodhet në ndërvarje të vijueshme, megjithatë poezia sërish bën përpjekje për pasqyrimin dhe përfytyrimin e njerëzimit të kohës.

Sidomos rrëfimi dhe skicimi psikoanalitik, ku krijuesi i njëmendtë ndihet në qarkun e kohës së vërtetë, duke e qëlluar mu në thelb habinë dhe mrekullinë e parë e të mbrame të botës sonë. Rasti shqiptar tek shkrimtarët disident ka të bëjë me durueshmërinë dhe palëkundshmërinë, që poetikisht gjallëron me qasjet krijuese novatore. Mirëpo, gjallimi njëmend vërshon parimin e qartë e të përcaktuar mirë, si kategori e jetës njerëzore. Hetuesi apokaliptik shqiptar, a thua nuk e realizoi përfytyrimin, durimin dhe qetësinë e brendshme që i parandjen gjërat, mbi të gjitha në mënyrë tronditëse duke mbetur pezull në hapësirën e veprimtarisë letrare. Mbase fund e krye mbarë pikësynimet e mundshme për zbatim, janë bërë në mënyrë qesëndisëse, në kriter vlerësimi, pra-

nimi ose përjashtimi? Pikërisht si floçkat në poezi, që prej kohës së De Radës e gjer në kohërat e sotme pikaset zona e imagjinuar. Qenia e gjallë e pabesueshme, si rëndom vetë ne, kurdoherë e hamendësojmë paradoksalen kur synojmë të futemi në historinë letrare. Përshkrimi i kohës, shpaloset në të nesërmen e njerëzores, kur me hijen e saj mbulon hapësira të tëra letrare të përjetësisë. Përveç ëndërrimit të thellë, përfytyrimin esencial dhe imagjinatës së domosdoshme, kurrfarë vërtetësie tjetër nuk pandeh të lëvizë në përkufizimin e specifikës së faktit letrar. (Plasari A., 1996: 11) Poezisë i përket nami pse ka vepruar në errësirë sikurse në agim, kundrejt forcës së mbinatyrshme të errësirës së ferrit të censurës ideologjike. A thua sot, kjo poezi nuk sjell në kohën tonë veçse përzemërsira të përkryera, adhurime ditëprera, me botën e saj të vërtetë? Këtë konstatim e justifikojmë me *Këngët e Milosaos*, të cilat ashtu si ato të *Serafina Topisë*, kanë të bëjnë me mrekullirat krijuese të gjeniut tonë. Kur mësojmë për fatin e vjershëtorit, për rrethanat e caktuara, për shijet dhe parapëlqimet letrare, faktikisht mësojmë për tërësitë kulturore e letrare të një periudhe. Megjithatë mjaft simptomatike ka qenë pyetja se çfarë kanë synuar koha – poezia – sistemi ideologjik prej njëra-tjetrës? Lojën për pavarësi, për ndikim apo diktat? Platforma liberale e Sejfulla Malëshovës e rrezoi “ndërtesën” e tij shoqërore e letrare plot kundërshti, të ngritur me ndihmesën atdhetare demokratike në vitet ‘20-’30 (Kuçuku B., 1996: 38). A s’është kjo vallë theqafje politike e qarqeve të mbyllura që ushtrohet mbi autorin dhe veprën, apo vetëm parapëlqim dhe kënaqësi e re ndaj gjërave të moçme të trashëgimisë historike, që vjen nga shekujt ose diçka tjetër? Paraqitja në skenë, brenda lirisë së fjalës së zotuar – na duket vetëm fjalë e shpresës së madhe, apo përfundim i vërtetë, që është ndoshta nismë e përkryer imagjinare? Është ky tipari dallues i një pjese të rëndësishme të trashëgimisë sonë letrare që kërkon t’i bëjmë analizë imanente botëkuptimit tonë mbi civilizimin e kësaj periudhe. Letërsia shqipe e ka shfaqur veten si përfytyrim mbi sistemin letrar, sepse është e lidhur me problem i shijes së lexuesit. Pavarësisht nga stili, orogjinaliteti krijues, nuk të shpie në hutim, harresë ose përjetësi që të del

nga mendja? Të qenët i papërlyer dhe i pastër, të përmendësh të papërmendurën, të dalish në dritë nga sprovat e kohës që të lëndon, thotë Migjeni në *Bukuria që vret*, atëherë çfarë pohimi të poezisë paraqet kjo?

Sikurse shihet këtu skutëlohet dhe kamufluhet prushi nën shpuzë e vrug, Bogdani, shkruante për ta luftuar apostazinë me çka njerëzorja mbetet apo humb (Plasari A., 1996: 10). Poezia ka të ngjarë të kuptohet dhe interpretohet si një hijez imagjinate apo vegimi me kohën, që njëkohësisht globin e imagjinojnë si arenë personale. Si duket imagjinata del mjaft e vullshme, sa që i ndal gjilpërat e sahatit të cilat shndërrohet në kryefjalë, synim dhe vëmendje. Vijimësia e zhvillimit, mbase e pasqyron gjithë qenien e poezisë. Mirëpo përmes bredhjes së saj brenda kohës, apo lojës së mjediseve shoqërore shqiptare, përgjithësimin e cilitdo përkufizimi apo shprehjeje e presin një sërë të papriturash. Fatmirësisht, parashtresa krijuese letrare duket e dyanshme, me ndikime të ndërsjella. Nuk të habitin veçse raportet letërsi-shoqëri në rastin tonë. Ndonëse poezia ka gjasa të të habitë, me prejardhjen ose me vijimësinë e saj, pikërisht brenda hapësirës së hutimit dhe daljes nga mendja. Atje, na përngjanë se letërsia nga kufizimet e realizmit socialist ka pësuar disfatë, brenda vorbullës së ndodhive të kohës, por disa shkrintarë të njohur, si Camaj, Koliqi, Kuteli, Poradeci, Kadare, Arapi e ndonjë tjetër kanë krijuar vepra artistike në kuptimin e plotë të fjalës.

Ashtu sikur ka herë nga forca e tejkalluar botkuptimore, ideologjike dhe teorike, poezia e Fishtës e vështruar realisht për nga trajta apokaliptike shpërmdahet nëpër nivelet e rretheve të vërteta në zemrat e shqiptarëve, edhe pse vazhdon të quhet "fashist" nga "pushteti popullor i monizmit". Fati i një populli nuk lidhet vetëm me rivalitetet politike e ekonomike, por me kapacitetin e zotësisë për të qenë në gjendje ballafaqimi me rivalitetin kulturor. Poezia jeton, gëlon, rigjallërohet, lëviz dhe qarkullon me kohën, në rast se e mposht forcën e dëshmimeve të përfunduara, gjatë lirisë dhe pavarësisë së ligjërit poetik. Vargu është më bashkëkohor e më modern, në këtë rrafsh mund të hiqen paralele me letërsinë italiane e atë evropiane. Koha përnjëherësh, pa

vonesë lundron në drejtim të kahut të orientimit të kufizuar – gjer tek mëshira e folesë shpirtvogël e zemërlepur të rrethanave të vërteta. Vërtetësia më e fuqishme dhe më e vullshme duket më e prirur drejt gremisjes. Mbase veçse aq, pikërisht humori i zi e duron përbindëshin e njëmendësisë, gjithë mëdyshjen e saj, duke u shndërruar kështu në parime dhe rregulla përkrahëse poezinë. Mirëpo mundësia apo zgjidhja e opozitës së vërtetë e të fuqishme poetike për shoqërinë shqiptare, është jashtëzakonisht e vendosur dhe më pas bëhet realitet. Gjallëria e ëndërrës së paplotësuar, njësoj si logjika e dëshmimeve të përfunduara, i përket dialektikës së vërtetë të të qenurit real. Si poet i mundshëm në njeriun, njeriu i mundshëm gëlon ose jeton tek vetë poeti ynë Migjeni. Aq më tepër, ndonëse është krijuar në kohën e një regjimi totalitar në Shqipëri dhe në kohën e politikës shtypëse serbe, shumë të pasigurt dhe djallëzore ndaj shqiptarëve në Kosovë, poezia mbetet po ajo kohë e vërtetësisë dhe njerëzore, ngase disponon, kurajon dhe imagjinojnë sqarimin e saj të domosdoshëm e të përkryer. Shikuar realisht sa më i ngushtë që të duket horizonti përqark saj, aq fortë dhe realisht poezia si poezi e vërtetë, konkretizon dhe paragjykon sprovën e padjallësisë, lojën njerëzore, të lindjes edhe një herë tjetër, të sprovës jetësore të qarkut të mbyllur.

Ndërkohë *Pasqyrat e Koliqit* ndër të tjera tregojnë krijimin e artit të fjalës kur i përfaqësojnë misionit të saj, ngaqë do të hartohet të nesërmen, kur do të lirohet nga nënshtrimi i kohës. Mjaftë treguese e domethënëse ndaj vështrimit të njeriut në liri – është poezia e Migjenit, e cila si e tillë na sjell ndër mend unën e saj, thelbin dhe ëndërrimin dalldisë, ku pas secilit ngadhënjim ka pësuar humbje dhe pas çdo dështimi ka ngadhënjyer. Çuditërisht poezia e Fishtës quhet ekstreme nga ideologjia komuniste, për arsye se ishte trashëgimtare që lindi nga të parët e vet. Pikërisht kjo ideologji e kundërshton pozitën e të parëve, adhuron mjedisin e kalamajve të palindur!? Duket qartë se është një ndryshim midis kohërave të vjetra e bashkëkohore, ku poezia e sotme gjithashtu e synon sendërtimin e detyrimit dhe zotimit të përgjithshëm njerëzor. Peripecia e këtyre e padiskutueshme e poetit e gdhend arsyen dhe hakun e tij kundrejt

një kohe të tillë. Si poezi e ndërjegjshme për unin personal, e cila hartohet nga gjurmët dhe pamjet e këndit të kundërt të kohës, për të nesërmen me perspektivë. Atëherë përse sot, çdo krijim poetik i vërtetë dhe origjinal, shfaqet brenda një momenti, si veçori dhe varietetet i pashprehur.

Poezisë i përket gjendja dhe pozita dialektike moderne. Këtu hyn letërsia individuale e kritike e Konicës në fillim të shekullit, si nismëtare e modernitetit shqiptar. Detyrimi dhe kërkesa për bashkëbisedim më të sinqertë me jetën shoqërore të vërtetë. Letërsia moderne e viteve '20 e '30 e Koliqit, Poradecit, Migjenit, Kutelit, ajo e viteve '60 dhe '70 e Kadaresë, Pashkut, Bilal Xhaferrit dhe Z. Rrahmanit. Gjithashtu arsyeja e vërtetë për dramë, për mrekulli, njëkohësisht do të thotë se njeriu poetikisht jeton dhe gëlon mbi truall. A pandeh ta vështroj kohën e vërtetë duke u përpjekur të shfaqet si mjellma për ta ndërë përjetësinë. Poezia shëmbëllen e para dhe njëkohësisht e mbramja, si forcë e dliurë njerëzore. Si art dhe si lëndë e ëndërrimit, poezia na lë të kuptojmë se nuk duket dytësore apo e lënë pas dore, prorre është *modus vivendi* më i rëndësishëm i njeriut. Duke u nisur nga poezia e përhapur dhe e njohur, tepër e ndjeshme, e modeluar, luf-tarake, tallëse dhe përqeshëse e gjer tek kultura poetike ezoterike. Sodi-tja e zhytur në mendime, avangarde, poezia brenda kohës, pos tjerash duket si një kërkim, lëvrim, vëzhgim, gjurmim dhe hetim polifonik i rrethanave, që me bredhjen njerëzore e zëvendëson praninë e të qenurit me një domethënie njerëzore. Mjeshtëria poetike, brenda kulmit vlues të kohës, gjithashtu mund të

kuptohet si përjetësi dhe liri që qarkullon brenda mjedisit. Sikurse thotë *Elioti*, njerëzimi akoma mëtej po na thërret ta zbulojmë qenien tonë. Njeriu i sillet qenies së tij, të panjohurës. Megjithatë ky duhet të jetë gjithë rrugëtimi i poezisë nëpër kohë. Thirrja e poetit të gëzueshëm tregon se nuk do t'u rrekemi hulumtimeve, edhe pse fundi i hulumtimeve tona prapë do të arrij atje prej ku u nisëm në vendin tonë për të parën herë e njohëm. Nëpër dyer të panjohura, që na kujtohen, kur edhe skuta e fundit e tokës për zbulim ende është ajo që ka qenë në fillim.

BIBLIOGRAFI

- AUTORË TË NDRYSHËM (1983), *Historia e letërsisë shqiptare*, botim i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë.
- ARAPI, F. (1974), *Poezia shqipe*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë.
- HAMITI, S. (1989), *Vetëdija letrare*, "Rilindja", Prishtinë.
- KOLIQI, E. (1931), "Misioni i letrarëve të rinj shqiptarë", *Leka*, nr. 2.
- KONICA, F. (1993), *Vepra*, Tiranë.
- KUÇUKU, B. (1996), "Biografia e shkrimtarit nuk është kriter vlerësimi për veprën", *Letërsia si e tillë*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Toena, Tiranë.
- PLASARI, A. (1993), *Letërsia dhe muret*, Tiranë.
- PLASARI, A. (1996), "Probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare", *Letërsia si e tillë*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Toena, Tiranë.
- QOSJA, R. (1972), *Kontinuitete*, Prishtinë.
- RESSULI, N. (1940), "Përsëri mbi pjesëtimin e historisë së letërsisë shqipe", *Shkëndija*, Tiranë.
- SHEMA, I. (1995), *Vrojtime letrare dhe artistike*, "Rilindja", Prishtinë.